

RAPORTI I KRYETARIT TË SHOQATËS 17SHKURTI.CH



Avni Kastrati – Kryetar i Shoqatës

Tel. +41 76 305 00 00

E-Mail : avnija.12@hotmail.com

Data: 25.01.2015

Të nderuar anëtar të shoqatës dhe mysafirë. Në Kuvendin e kaluar mora besimin tuaj që edhe për një vit të jemë kryetar i shoqatës 17shkurti.ch. Isha shumë i vetëdijshëm që kisha marrë një përgjegjësi të madhe mbi vete. Nuk ishte e lehtë, që shoqatën edhe në vitin e gjashtë me rradh, ta mbajmë në një ritëm të lartë. Megjithatë besoj se kemi kryer punë të mëdha.

Mbledhjet e kryesisë

Në vitin që e lam pas kemi mbajtur 6-7 Mbledhje të kryesisë. Përveç këtyre mbledhjeve kemi mbajtur edhe shumë takime. Takimet na kanë ndihmuar, që mbledhjet zyrtare të jenë më të shkurtra dhe më efikase.

Anëtarësia

Edhe këtë vit numri i anëtarëve ka shënuar rritje, por duhet theksuar se poashtu ka raste kur anëtarët e deritanishëm, për arsye që vetëm ata i dinë, nuk e kanë kryer obligimin ndaj shoqatës për vitin 2014. Numri i anëtarëve ka arritur deri në 220. Ndërsa numri i anëtarëve të rinjë për këtë vit është rreth 10 vetë. Ndërsa numri i anëtarëve lokal ka arritur mbi 36.

Projekte

Gjatë këtij mandati janë realizuar disa projekte të ndryshme :

- Ndihme për shkollën (laboratori i Kimisë)
- Mirëmbajtja e fshatit
- Mirëmbajtja e lumit & varrezave
- Projekti reciklimit PET-ALU
- Blerja e makinës së barit për Danin
- Mbjedhja e luleve nëpër fshat
- Java Kulturore
- Renovimi i stacionave të busit & vendosja e shportave për duhan
- Rregullimi i urës afër xhamisë së epërme - për Lule
- Ndrimi i disa poqave - Ndrim publik
- Parkingu për bicikleta
- Renovimi i ulsëve dhe shportave të parkut

- Aksionipër zhveshtoren e futbollit
- Aksioni « Participim për ndërtimin e një shtëpie »
- etj.

Në fund

Për gjitha këto projekte, suktesi dhe lavdata nuk më takojnë mua, por juve anëtarë, sponsor, aktivist dhe kryesi e nderuar.

Faleminderit

Avni Kastrati
Kryetar i Shoqatës 17shkurti.ch